



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
NDËRMARRJA E MIRËMBAJTJES SË INFRASTRUKTURAVE DHE PUNËVE PUBLIKE
SEKTORI MBËSHTETËS

Pogradec, më 19.06.2023

PROCESVERBAL –TIPI I KONTRATËS - SHERBIME

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT: “Hartim plani, Mbarshtim dhe menaxhimi ekonomia Pyjore
Mokër 1”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Shërbimet pyjore 77200000-2

Shërbime të pylltarisë 77230000-1

Shërbimet për menaxhimin e pyjeve 77231000-8

Shërbime të pyllëzimit 77231600-4

VLERA E FONDIT LIMIT: 8,774,645 (tetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e dyzet e pesë) **lekë pa TVSH.**

Bazuar ne nenin 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, NMIPP, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Kriteret e Përgjithshme të Pranimiit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5;*

Argumentimi: *Kerkesa 1. a bazohet ne nenet 76,77 dhe 82 të LPP si dhe nenit 26 te VKM nr 285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar.Kerkesa 1.b eshte vendosur bazuar ne nenin 83 te LPP dhe nenit 30 pika 1 te VKM-së Nr.285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojces 11.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2 germa c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedures eshte sherbim konsulence, nen kufirin e ulët monetar, përcaktimi i vlerës së kërkuar eshte bere ne mbeshetje te nenin 43, pika 2, germa "c" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet se: Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit "Shërbim konsulence".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar eshte bere ne mbeshetje te nenin 43, pika 1 " të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet se: "Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare", Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij., VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i sherben AK per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare (2020, 2021, 2022), të konfirmuara nga Administrata Tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të

ardhurat tatimore : Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limitit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Ne rastin e bashkimit të operatoreve secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të përmbushë kërkesat e mesiperme në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në shërbim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Argumentimi: *Kërkesa e mesiperme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 dhe 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2. Operatori Ekonomik ofertues duhet të disponojë dhe të paraqesë Licencën profesionale të shoqërise për realizimin e shërbimeve objekt kontrate Kodi III-7A ”Shërbime të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me pyjet apo kullotat” leshuar nga QKL.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 41, pika 4/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në VKM nr.538 date 26.05.2009 ” Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet QKL dhe disa rregullave te tjera nenligjore te perbashketa” e ndryshuar.*

Kjo kategori licence i referohet zërave të punimeve të parashikuara në preventivin e punimeve objekt prokurim.

2.3.3 License Kodi III.2.A “Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis”, leshuar nga QKL-ja sipas përcaktimeve ligjore.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 41, pika 4/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në VKM nr.538 date 26.05.2009 ” Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet QKL dhe disa rregullave te tjera nenligjore te perbashketa” e ndryshuar.*

Kjo kategori licence i referohet zërave të punimeve të parashikuara në preventivin e punimeve objekt prokurim.

2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues për realizimin e shërbimit duhet të ketë në përbërje specialiste të profileve me eksperience pune në fushat respektive në profesionet si më poshtë:

-1(nje) Inxhinier Pyjesh, me përvojë në hartimin e Planeve të Mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, menaxhimit të qendrushëm të tyre, aspekteve silvo-teknike, të mbrojtjes dhe zhvillimit të burimeve natyrore, i cili do të jete edhe drejtues i stafit teknik të pajisur me: Kontratë pune e vlefshme (përkatëse), Diplomë, CV si dhe me certifikate profesionale për shërbime profesionale për projektme sipas gërmes c) pika 1 neni 3 i Rregullores nr.3 date 08.07.2009 ”Per çertifikimin e shërbimeve të ekspertizës dhe profesionale në pyje dhe kullota”. Inxhinieri të jete në listepagesat e shoqërise për 3 muajt e fundit nga dita e hapjes së ofertave.

-1(nje) Inxhinier Pyjesh, me përvojë në punimet e terrenit për hartimin e planeve të mbarshtimit, përdorimin e teknologjise në regjistrimin online të të dhënave dhe që njeh mirë territorin në studim. Inxhinieri të jete i pajisur me: Kontratë pune të vlefshme (përkatëse), Diplomë, CV si dhe të jete në listepagesat e shoqërise për 3 muajt e fundit nga dita e hapjes së ofertave.

Ofertuesi i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe brenda afatit të përcaktuar në kërkesën për dorëzim dokumentacioni pranë AK, dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të parashikuara në pikën 2 të nenit 26 të VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është vendosur bazuar ne manualin e Mbareshtimit te Integruar Te Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me nr. 864 prot, date 30.01.2019 ”Kontrolli i disponibilitetit dhe aftesive profesionale te stafit teknik” si dhe pikes 4, te nenit 77 te ligjit nr.162, date 23.12.2020 ”Per prokurimin publik” dhe nenit 41 pika 4 germa b dhe c te VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me ane te ketij kriteri kerkohet qe OE te kene stafin teknik te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit.

2.3.5 Operatori Ekonomik ofertues për realizimin e shërbimit duhet të ketë në përbërje:

- **1 (nje) Specialist qe njih dhe perdor programet ne GIS** (Inxhinier topograf/gjeodet), **per** ndarjen e ngastrave e n/ngastrave, pergatitjen e hartave te ndryshme sipas termave te references (dixhitalizimin, gjeoreferimin etj), perpunimin dhe menaxhimin e te dhenave dixhitale, i pajisur me Licencen ne fushen e projektiveve, nga autoritetet kompetente ligjore.

Eksperienca e punes dhe profilet e specialisteve te stafit teknik/eksperteve kryesore qe do te angazhoje ne kryerjen e ketij studimi, do te duhet te vertetohen nga ana e kontraktorit me kontratat e premtim angazhimit (e vlefshme gjate kohes se hartimit te planit) diplome, CV, Çertifikate kualifikimi, studime dhe ose rekomandime si dhe te jete ne listepagesat e shoqerise, për 3 muajt e fundit nga data e hapjes se tenderit.

Ofertuesi i kualifikuar i pari duhet te dorëzoje përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe brenda afatit te percaktuar ne kerkesen per dorezim dokumentacioni prane AK, dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të parashikuara në pikën 2 të nenit 26 te VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është vendosur bazuar ne manualin e Mbareshtimit te Integruar Te Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me nr. 864 prot, date 30.01.2019 ”Kontrolli i disponibilitetit dhe aftesive profesionale te stafit teknik” si dhe pikes 4, te nenit 77 te ligjit nr.162, date 23.12.2020 ”Per prokurimin publik” dhe nenit 41 pika 4 germa b dhe c te VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me ane te ketij kriteri kerkohet qe OE te kene stafin teknik te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit.

2.3.6 Kandidati ofertues duhet të kete pjese te stafit nje biolog dhe te kete te shoqeruar me dokumentacionin e meposhtem:

- a) Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
- b) Diplomë
- c) CV

Ofertuesi i kualifikuar i pari duhet te dorëzoje përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe brenda afatit te percaktuar ne kerkesen per dorezim dokumentacioni prane AK, dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të parashikuara në pikën 2 të nenit 26 te VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë

elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është vendosur bazuar ne manualin e Mbareshtimit te Integruar Te Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me nr. 864 prot, date 30.01.2019 "Kontrolli i disponibilitetit dhe aftesive profesionale te stafit teknik" si dhe pikes 4, te nenit 77 te ligjit nr.162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe nenit 41 pika 4 germa b dhe c te VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Me ane te ketij kriteri kerkohet qe OE te kene stafin teknik te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit.

Bazuar ne Manualin e Planeve te Mbareshtimit te Pyjeve dhe Kullotave 2019, faqe 62-63 te tij, Specialisti i fushes vlereson se Plani i Mbareshtimit mbart ne vetvete edhe procesin e mbledhjes se te dhenave mbi biodiversitetin, qe do te grumbullohen nga vrojtimi ne terren gjate fazes se pershkrimt parcelar dhe ky informacion ruhet ne SISP.

Te dhenat kryesore duhet te fokusohen ne :

-biotopet (shiko Standartin 5)

-habitatet

-specie e kercenuara (shiko Aneksin 10)

-vegjetacionin potencial (shiko Aneksin 11)

-rezervat biogjenetike

Eshte e nevojshme qe te grumbullohen edhe te dhena nga studime te tjera dhe te integrohen ne planin e mbareshtimit si: raportet ekologjike, planet e vjetra te mbareshtimit dhe publikime te tjera (si psh:Rrjeti i Natyra 2000 per habitatet) dhe informacioni lokal. Duhet te percaktohet nje liste me elementet ekzistues te biodiversitetit ne Ekonomine Pyjore duke iu referuar kategorive te meparshme dhe parcelave dhe paraqitini ato ne harten e planit. Duhet te pershkruhet rendesia dhe impakti mbi ekosistemet.Te gjitha proceset e mesiperme, realizohen nga nje biolog.

2.3.7 Kandidati ofertues duhet të kete pjese te stafit nje Specialist Mjedisi dhe te kete te shoqeruar me dokumentacionin e meposhtem:

a) Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)

b) Diplomë

c) CV

Ofertuesi i kualifikuar i pari duhet te dorëzoje përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe brenda afatit te percaktuar ne kerkesen per dorezim dokumentacioni prane AK, dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të parashikuara në pikën 2 të nenit 26 te VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është vendosur bazuar ne manualin e Mbareshtimit te Integruar Te Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me nr. 864 prot, date 30.01.2019 "Kontrolli i disponibilitetit dhe aftesive profesionale te stafit teknik" si dhe pikes 4, te nenit 77 te ligjit nr.162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe nenit 41 pika 4 germa b dhe c te VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Me ane te ketij kriteri kerkohet qe OE te kene stafin teknik te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit.

Ekonomia pyjore Moker 1 shtrihet në altitude 600m- 1240m mbi nivelin e detit me kundrejtimit veriperendim, kjo ekonomi pyjore ka ne brendesi te konturit te shtrirjes se saj zona te banuara, komunitete te cilet bashkejetojne ne kete mjedis rrethues. Zona fitoklimatike e ekonomise pyjore eshte Zona e Ahut Fagus Sylvatica (nënzona e Lisit Quercus), prek bimesi ku jane te rezikuara sipas IUCN-se, tipet e tokave prezente kemi: të kafenjta; të hinjta të kafenjta dhe të murrme pyjore. Persa me siper kjo ekonomi pyjore ka aktivitet te larte minerar, ku operojne subjekte objekti (karriere e hapur) per shfrytezimin e mineraleve, pjese e fondit pyjor/kullosor. Eksperti mjedisor duhet te vlersoje impaktin mjedisor qe keto subjekte kane mbi llojet pyjore, dhe bimesine, token qe me veprimet e tyre pakesojne siperfaqen pyjore si ne volum por edhe ne siperfaqe. Menyra dhe rehabilitimi nepermjet pyllzimit te kompensues, te vlersoje impaktin mjedisor duke gene se keto subjekte operojne ne afersi te komunitetit (qendra te banuara), si dhe rreziku i mundesise se humbjes se nivelit te ujrave freatik nentokesor, pra nje vlersim mbi bashkeveprimin reciprok te komponenteve te ekosistemit si: bime, toke, ajer, uje, kafshe. Per sa me siper, eshte e nevojshme qe OE të kete pjese te stafit nje Specialist Mjedisi.

2.3.8. Një punësim mesatar i të paktën **9 (nente)** personave, për 3 muajt e fundit nga data e hapjes se tenderit, të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për 3 muajt e fundit nga data e hapjes se tenderit.
- Listpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për 3 muajt e fundit nga data e hapjes se tenderit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe C), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Njesia e prokurimit per vendosjen e stafit i eshte referuar Termave te references, te publikuara ne SPE.

Pervec personelit kryer te percaktuar nga pikat 2.3.4 -2.3.7,per realizimin e kontrates ne teresi te vet , posacerisht per realizimin e punes ne terren, specialisti i fushes argumenton se duhen te pakten nje grup pune ne terren i perbere nga :

- Nje diameter mates
- Nje punetor per matje
- Nje punetor per bojatisje
- Nje mbajtes materialesh ndihmese.

Per sa me siper , nevojiten qe ne listpagesat e shoqerise ofertuese, te figurojne te pakten 9 vete, dhe te vendoset kriteri 2.3.8 me permbajtje si me lart.

2.3.9 Per stafin kryesor te angazhuar operatori duhet te paraqese deklarate disponueshmerie per kryerjen e sherbimit qe kerkon te realizoje.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 41, pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- b) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- c) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, staf i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

2.3.10 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të ketë certifikata cilesie në gjuhën shqipe, ose të perkthyer dhe të noterizuara për fushën e veprimtarive: "Shërbime profesionale për zbatim në pyje dhe kullota" që përfshihenShërbime profesionale për projekte komplekse të menaxhimit të pellgjeve ujëmbledhës, plane mbarështimi të pyjeve, kullotave, florës dhe faunës....., si më poshtë:

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, në fushën e veprimtarisë që konkuron, sipas standardit ndërkombëtar **EN- ISO 9001-2015** (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalente të saj. Certifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë që vërteton sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë, sipas standardit ndërkombëtar **ISO 45001-2018**. Certifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesat e mesipërme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”

Çertifikatat e cilësisë janë bazuar në përputhje me objektin e zbatimit që do të zbatohet dhe janë në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet.

Në zbatim të pikës 1 të nenit 79 të ligjit për prokurimin publik, ku shprehet se “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, **duhet që O.E pjesëmarrës të jete të pajisur dhe të paraqesin certifikatat perkatese të vlefshme, të lëshuara nga institucionet zyrtare të akredituar për këto qëllime, të vendoset kriteri i sipërcituar.**

Keshtu, duke u mbeshtetur tek zerat e preventivit ne perpjesetim dhe te lidhur ngushte me objektin qe prokurohet, per te percaktuar certifikatat konkrete, specialisti i fushes per kete objekt u mbeshtet ne nenin 79 te Ligjit nr.162/2020 "Per prokurimin publik " si dhe te neni 44 te VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar, Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit, Operatori ekonomik duhet te paraqese certifikatat ISO si me lart.

2.3.11 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë.

Mjetet	Sasia	Gjendja
Automjet	1 copë	Pronësi/me qera/ose huaperdorje
Teodolit	1 cope	Pronesi/qera/ ose huaperdorje
Aparat GPS (Gipies)	1 cope	Pronesi/ qera/ ose huaperdorje

1.Për Automjetin në pronësi mjetet duhet të paraqiten dokumentat si me poshtë:

- a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit;
- b) leje qarkullimi;
- c) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm)

2.Për Automjetin e marre me qera duhet të paraqiten dokumentat si me poshtë:

- a) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij nga ana e qeradhenesit.
- b) lejë qarkullimi;
- c) siguracionin e mjetit,(i vlefshmëm);
- d) Kontraten e qerave e vlefshme gjate gjithë periudhes se zbatimit te sherbimeve.

3.Për Automjetin e marre me huaperdorje duhet të paraqiten dokumentat si me poshtë:

- a) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij nga ana e huadhenesit.
- b) lejë qarkullimi;
- c) siguracionin e mjetit,(i vlefshmëm);
- d) Kontraten e huadhenies e vlefshme gjate gjithë periudhes se zbatimit te sherbimeve.

4. Per mjetet qe nuk shenohen ne regjistrat publike duhet te paraqese aktet e zhdoganimit ose faturat e blerjes, origjinale ose fotokopje e noterizuar. Per mjetet e marra me qera/ose huaperdorje te paraqitet edhe kontrata e qerave/huadhenies e vlefshme gjate gjithë periudhes se zbatimit te sherbimeve.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Nga analizimi i preventivit per realizimin e sherbimit, nevojitet nje mjet per transportin e punonjesve, nje instrument mates per piketimin e rrugeve, per percaktimin e kullotave dhe

lartesine mbi detin si dhe per matjen e kendeve-Teodolit dhe nje pajisje GPS-Per percaktimin e nje pike te sakte, gjetjen e saj, per matjen e distancave.

Në rastet e bashkimit të konsulentëve, kriteret e veçanta të kualifikimit plotësohen bashkarisht nga i gjithë bashkimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike : Termat e references/Preventivi/Argumentimi i nr. te punonjeseve per proceduren respektive jane hartuar nga specialistet e fushes se Sektorit te Pyjeve.

Termat e references/Preventivi jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.

Fondi Limit i perllogaritur per kete procedure eshte hartuar ne baze te VKM nr.361 date 12.05.2010 ''Per Miratimin e Tarifave te sherbimeve profesionale qe kryhen ne fondin pyjor e kullosor publik''.

Vendosja dhe argumentimi i kriterëve/Hartimi i kërkesave për kualifikim lidhur me kapacitetet teknike për këtë objekt prokurimi është bërë nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit, në respektim dhe të parashikimeve të nenit 74/4 të të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

NJESIA E PROKURIMIT